



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kuvendi i Komunës së Prizrenit

Komiteti për Komunitete

Nr. 001/060 – 57066

Më 14 maj 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, thërras mbledhjen e Komitetit për Komunitete, që do të mbahet më **21 maj 2026 (e enjte)**, në sallën për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në **ora 13:00**.

Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Komitetit për Komunitete të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhje, duke i'u përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë:

RENDITE

1. Shqyrtimi i përmbledhjes së raportit vjetor 2025 të Zyrës për Komunitete dhe Kthim;
2. Prezantimi i aktiviteteve kryesore dhe të arriturave gjatë vitit 2025;
3. Diskutim mbi sfidat me të cilat është përballur Zyra gjatë vitit raportues dhe rekomandimet për avancimin e punës;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete
Sevilay Igci Hapçi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Skupština Opštine Prizren
Komitet za Zajednice
Br. 001/060 – 57066
Dana 14 maj 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Na osnovu člana 11 Administrativnog uputstva (MLS) br. 05/2020 o postupku za osnivanje, sastav i nadležnosti stalnih komiteta i drugih komiteta u opštini, sazivam sastanak Odbora za zajednice, koji će se održati **21 maja 2026. godine (Četvrtak)**, u sali za sastanke Skupštine opštine Prizren, u „Bijeloj kući“, sa početkom od **13:00 časova**.

Stoga ste pozvani da učestvujete u radu ovog sastanka u svojstvu člana Komiteta za zajednice, pridržavajući se utvrđenog vremena, datuma i mjesta.

Za rad ovog sastanka predlažem ovaj:

D N E V N I R E D

1. Razmatranje sažetka godišnjeg izvještaja Kancelarije za zajednice i povratak za 2025. godinu
2. Prezentacija glavnih aktivnosti i dostignuća tokom 2025. godine;
3. Diskusija o izazovima s kojima se Kancelarija suočila tokom izvještajne godine i preporuke za unapređenje rada;
4. Razno.

Predsedavajuća Komiteta za Zajednice
Sevilay İgci Hapçi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Prizren Belediye Meclisi
Topluluklar Komitesi
No. 001/060 – 57066
Tarih: 14 Mayıs 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Belediyedeki Daimi Komitelerin ve diğer komitelerin oluşum prosedürü, yapısı ve yetkilerine ilişkin 05/2020 sayılı İdari Talimatın (MPL) 11. maddesine dayanarak **Belediye Meclis toplantı salonunda saat 13.00 başlamak üzere 21 Mayıs 2026 tarihinde (Perşembe)** düzenlenecek olan Topluluklar Komitesi toplantısı için çağırıda bulunuyorum.

Topluluklar Komitesi üyesi niteliğinde işbu oturum çalışmalarını için belirtilen saat, tarih ve yerde katılmanız üzere davetlisiniz.

İşbu toplantı için aşağıda yer alanları öneriyorum

GÜNDEM

1. Topluluklar ve Geri Dönüş Dairesi'nin 2025 yıllık rapor özetinin görüşülmesi;
2. 2025 yılı boyunca gerçekleştirilen başlıca faaliyetlerin ve elde edilen başarıların sunumu;
3. Ofisin raporlama yılı boyunca karşılaştığı zorluklar ve çalışmaların geliştirilmesine yönelik tavsiyeler hakkında tartışma;
4. Çeşitli.

Topluluklar Komitesi Başkanı
Sevilay Iğci Hapçi



**Republika e Kosovës - Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti Komuna e Prizrenit - Opština Prizren - Prizren Belediyesi
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim – Opštinska Kancelarija za Zajednice i Povratak
Belediye Topluluklar ve Geridönüş Ofisi**

PLANI I PUNËS I ZYRËS PËR KOMUNITETE DHE KTHIM PËR VITIN 2026

Hyrje

Komuna e Prizrenit përmes Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, konfirmon vullnetin politik dhe përkushtimin e plotë të Komunës së Prizrenit për të ofruar një mjedis të sigurt dhe mundësinë e integritit të qytetarëve. Duke u bazuar në Rregulloren e zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim nr. 02/2010, Rregulloren (CRK) nr. 01/2018, për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të përhershme, Udhëzimin Administrativ nr. 01/2023 për Sistemin e Udhëheqjes, të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe Rregulloren (CRK) nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, fushat dhe aktivitetet e propozuara të cilat janë të paraqitura në Planin Vjetor 2023, shprehin qartë se çfarë duhet bërë për të përmbushur pritjet e këtij dokumenti, me qëllim të krijimit të mirëqenies ekonomike dhe sociale, përparimit social, një mjedisi më të sigurt për komunitetet joshumicë dhe integrimin e tyre të plotë në Komunën e Prizrenit.

Ky Plan Vjetor udhëhiqet nga një vizion i përgjithshëm për të kontribuar në zhvillimin e një shoqërie multietnike, progresive dhe demokratike me të drejta të barabarta. Për realizimin e këtij vizioni, plani vjetor mbështetet në synimet e mëposhtme që çojnë në drejtim të përmirësimit të kushteve për kthim të qëndrueshëm, riatdhesimin e personave të zhvendosur dhe përkujdesje për një numër të caktuar të personave të cenueshëm social, që jetojnë në Komunën e Prizrenit. Ato synime janë:

- Ofrimi i ndihmës për rastet e cenueshme sociale;
- Riatdhesimi dhe integrimi i personave të riatdhesuar në shoqërinë kosovare;
- Promovimi i procesit të kthimit.

Zyra për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Prizrenit, me mbështetjen e autoriteteve qendrore, do të bëj si në vijim:

- Do të zhvillojë komunikimin dhe do të forcojë bashkëpunim me organet përkatëse komunale;
- Forcimin e bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare;

- Inkurajimin e pjesëmarrjes së komuniteteve joshumicë në zhvillimin e politikave duke bashkëpunuar me organet komunale, hulumtuesit dhe propozuesit e metodave për komunikim më të mirë me komunitetet në nivel komunal;
- Të bashkëpunojë me ministrinë dhe organizatat përkatëse për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe mundësinë e zhvillimit dhe punësimit të komuniteteve joshumicë.

Pa mbështetjen dhe mirëkuptimin e faktorëve relevantë që lidhen me vlerat e një shoqërie multi-etnike, të avancuar demokratike dhe të barabartë, do të jetë e vështirë të zbatohet Plani Vjetor dhe të sigurohet përfaqësimi i barabartë i të gjitha komuniteteve në jetën publike. Këto aktivitete janë elemente themelore të qeverisjes së mirë që sigurojnë që politikat publike të marrin parasysh nevojat që mund të përfshihen.

PLANI I PUNËS, ZKKK - 2026

Nr. rendor	Aktivitete të përgjithshme të planifikuara	Perioda kohore	Përgjegjës për realizimin e qëllimeve të planifikuara
1.	ZKKK planifikon të shpërndajë dru zjarri, për rastet e cenueshme dhe skamnore nga radhët e komuniteteve joshumicë, për secilën familje nga 3m ³ . Përfituesit do të jenë: familjet nga komuniteti turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian dhe serbë.	Janar-Dhjetor 2026	ZKKK, Komuna- Prizren
2.	ZKKK planifikon të sigurojë pako ushqimore dhe higjienike për rastet të cenueshme dhe skamnore nga radhët e komuniteteve joshumicë. Përfituesit do të jenë: familjet nga komuniteti turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian dhe serbë.	Janar-Dhjetor 2026	ZKKK, Komuna-Prizren
3.	ZKKK do të bashkëpunojë me donatorë, organizata humanitare vendore si dhe organizata ndërkombëtare në ofrimin e ndihmave humanitare.	Janar-Dhjetor 2026	Org. Humanitare vendore dhe ndërkombëtare.
4.	ZKKK planifikon të mbajë një takim me secilin komunitet.	Prill – Shtator 2026	ZKKK, Komuna-Prizren
5.	ZKKK planifikon të plotësojë vendet e lira të punës brenda zyrës (zyrtar për komunitetin turk, zyrtar për komunitetin serb - rajoni i Zhapës dhe zyrtar për rajonin e Podgores).	Janar-Dhjetor 2026	ZKKK, Komuna-Prizren, Zyra e Personelit
6.	Lëshimin e vërtetimeve për trajtim shëndetësor për komunitetin turk si dhe arsimimin në Republikën e Turqisë.	Janar-Dhjetor 2026	ZKKK, Republika e Turqisë

7.	Lëshimi i vërtetimeve për punësim brenda Institucioneve të Kosovës për të gjitha komunitete jo shumicë si dëshmi se i takojmë komuniteteve jo shumicë.	Janar-Dhjetor 2026	ZKKK-ja
8.	Të dorëzohen raporte të rregullta të kryetari i Komunës dhe Komitetit për Komunitete sipas kërkesës.	Janar-Dhjetor 2026	ZKKK
9.	Pranimi dhe regjistrimi i personave të riadhesuar, vizita në terren, plotësimi i dokumentacionit nga ZKKK-ja për KKR, si dhe thirrja e takimit të KKR-së. Mbajtja e procesverbaleve, të shkruarit e vendimeve dhe nënshkrimi nga ana kryetarit të Komunës.	Janar-Dhjetor 2026	ZKKK, MUP- DRPRIH, CSR, DRSP. OJQ dhe organizatat ndërkombëtare qeveritare
10.	Takime, këmbimi i përvojave dhe bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, dhe me Institucionet të nivelit qendror ashtu edhe atij lokal, të Republikës së Kosovës.	Gjatë vitit 2026	ZKKK
11.	Vizitat dhe takimi me e Ministrin per Komunitete dhe Kthiim.	Janar 2026	ZKKK-ja
12.	Organizimi i vizitave SHKO- INFORMO që janë të zhvendosur sipas kërkesave të PZHI. Kjo duhet të jetë rezultat i punës së Grupit Punues Komunal. SHKO-SHIKO vizita me komunitetin vendas në ato vende ku janë vizita të planifikuara. Të mbahen deri kater vizita gjatë vitit.	Gjatë gjithë vitit 2026 sipas kërkesave të IRL-ve	Zyrtar Komuna, ZKKK, MKK, OSCE, IOM
13.	Mbajtja e rregullt e linjës në vendin me të kthyerit në fshatin Novake / relacioni Novake-Prizren-Novak.	Janar-Dhjetor 2026	ZKKK
14.	ZKKK-ja bashkë me KKV-ne do të angazhohen dhe do të punojnë në Implementimin e Planit të Veprimt për Gjithë përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkalije dhe Egjiptjan 2025-2028, edhe në buxhetimin e këtij plani, si dhe zhvillimin e aktiviteteve nga objektivat që figurojnë në plan neper komponentët e ndryshme.	Gjatë gjithë vitit pra periudha Janar- Dhjetore 2026	ZKKK dhe Kordinatori i KKV-së
15.	Aktivitete të tjera të paparashikuara ditore gjatë gjithë vitit.	Gjatë vitit 2026	ZKKK

Shkurtesat

ZKKK - (Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim);
MPB - (Ministria e Punëve të Brendshme);
MKK - (Ministria për Komunitete dhe Kthim);
DPRIH – (Departamenti për Personat e Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve);
OSCE - (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim);
QPS - (Qendra për Punë Sociale);
DPMS - (Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale);
IOM - (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin);
UNHCR – (Organizata Humanitare e Kombeve të Bashkuara për Refugjatë).
KKV - (Komiteti Komunal Veprues)



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren - Prizren Belediyesi

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim – Opštinska Kancelarija za Zajednice i Povratak
Belediye Topluluklar ve Geridönüş Ofisi

RAPORTI I PUNËS PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2025

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në Prizren është themeluar në vitin 2000, nga ana e Administratës të Përkohshme UNMIK-u. Në vitin 2010 është nxjerrë Rregullorja për zyrat komunale për Komunitete dhe Kthim, nr. 02/2010 e nënshkruar nga ana e ish-kryeministrit Hashim Thaçi. Në bazë të kësaj Rregulloreje, ZKKK-ja është pjesë integrale e Komunës dhe funksionon në kuadër të zyrës së Kryetarit. Roli i zyrës është integrimi i komuniteteve minoritare në të gjitha fushat e jetës në Komunën e Prizrenit. Në bazë të Planit të Punës, objektivat kryesore të ZKKK-së janë si vijon:

- 1. Ngritja e mirëqenies të komuniteteve minoritare,**
- 2. Kthimi i personave të zhvendosur nga regjioni,**
- 3. Qëndrueshmëria,**
- 4. Siguria,**
- 5. Riintegrimi i personave të riatdhesuar dhe integrimi i të huajve,**
- 6. Bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare,**
- 7. Shëndetësia,**
- 8. Arsimi,**
- 9. Ngjarjet fetare dhe kulturore,**
- 10. Trajnimet, punëtoritë, konferencat, komisionet dhe aktivitete tjera.**

1. Ngritja e mirëqenies të komuniteteve minoritare

- 1.1 Shpërndarja e pakove ushqimore:** Gjatë muajit të ramazanit, ZKKK-ja në bashkëpunim me Shoqatën Humanitare BEREQETI është bërë shpërndarja e pakove ushqimore për 100 familje nga komunitetet minoritare, dhe ato janë: 35 familje nga komuniteti Boshnjak, 35 familje nga komuniteti Turk dhe 30 familje nga komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
- 1.2 ZKKK-ja, në bashkëpunim me Shoqatën Humanitare BEREQETI, gjatë periudhës raportuese në muajin maj ka bërë shpërndarjen e veshmbathjeve për raste skamnore për komunitete jo- shumicë. Për komunitetin Rom, Ashkali dhe**

Egjiptian- 30 familje; për komunitetin Turk -30 familje; si dhe për komunitetin Boshnjak -15 familje.

- 1.3 Në fund të muajit maj, ZKKK-ja ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Humanitare BEREQETI për shpërndarjen e mishit për raste skamnore të komuniteteve jo-shumicë për rastin e festës së Kurban Bajramit,ku kane përfituar gjithsej 300 familje nga radhët e komuniteteve jo shumicë.
- 1.4 ZKKK-ja, sipas planit të punës për vitin 2025, e ka shpall thirrjen publike për ndarje të subvencioneve dhe transfereve për persona fizikë për furnizim me dru për ngrohje, si dhe pako ushqimore dhe higjienike për familjet skamnore nga radhët e komuniteteve minoritare, duke u bazuar në rregulloren e Komunes për kushte, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe transferve dhe grantet me nr. 001/011 – 201.
- 1.5 Thirrja është hapur me datë 27.05.2025 deri më 27.06.2025.
- 1.6 Pas përfundimit të thirrjes për pako ushqimore dhe higjienike kanë aplikuar **642** familje skamnore prej këtyre **355** kanë përfituar.Në radhët e komuniteteve Boshnjak kanë përfituar **162**,Turk **89**, Rom,Ashkalij Egjiptan **63**, Sërb **41** ndërsa të tjerë nuk i kanë përmbushur kriteret e nevojshme.Për dru zjarri kanë aplikuar **652** familje prej këtyre **354** perfitues nga radhët e komuniteteve Boshnjak kane përfituar **163**,Turk **87**, Rom,Ashkalij Egjiptan **62**,Serb **42**.

Kemi pasur edhe **37** kërkesat nga komuniteti Shqiptar,por nuk ka asnjë të aprovuar sepse thirja ka qenë vetëm për komuniteti jo shumicë.

Kemi pasur 22 ankesa që janë shqyrtuar nga komisioni për ankesa ku të gjithë janë të rrefuzuar.

1.7 Në fillim te muajit Tetor është bërë shpërndarja e të dy projekteve të ZKKK-së: Projekti për dru per ngrohje si dhe shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike

Banim dhe strehimi - Në periudhën raportuese, nga ana e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, jane ndërtuar 2 shtepi banimi për komunitetin Sërb të cilat janë dëmtuar nga zjarri dhe dy të tjerë për komunitetoin Romë.

2. Kthimi i personave të zhvendosur nga regjioni

2.1 Gjatë periudhës raportuese, ZKKK-ja ka pranuar 5 kërkesa për kthimin e personave nga regjioni.

2.2 Zyrës iu drejtuan persona të zhvendosur që duan të aplikojnë sërish në procesin e kthimit. Personave të zhvendosur u shpjegohet se cilat dokumente duhet të futen në bazën e të dhënave të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

2.3. Përfaqësuesit e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim kanë pasur dy vizita “Shko Informo” ku i kanë vizituar gjithsej 31 familje në Serbi. Qëllim i vizitës do të jetë informimi i personave të zhvendosur për dokumentacionin e nevojshëm të mëvonshëm, i cili kërkohet për përfshirje në sistemin e menaxhimit të rasteve.

2.4 Komisioni komunal për kthim ka rishqyrtuar 11 kërkesa prej këtyre 6 janë aprovuar nga Komisioni Komunal për Kthim.

3. Qëndrueshmëria

3.1 Gjatë periudhës raportuese është mbajtur një takim me Organizatën Integra dhe Komunën e Prizrenit. Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi i riatdhësimeve dhe rasteve tjera të komuniteteve të Prizrenit që janë të angazhuara në ngjarjet e QAK-ve (Qendrat e Aktivitetit të Komuniteteve) për të mbështetur dhe promovuar qytetarinë aktive. Këto takime janë bërë edhe në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin me qëllim të krijimit të një ndikimi pozitiv dhe forcimit të lidhjeve shoqërore. Janë mbajtur 3 takime me tema të ndryshme.

3.2 ZKKK-ja rregullisht ofronte shërbime transporti në linjën Novake-Prizren-Novake.

4. Siguria

4.1 Zyrtarët e zyrës së ZKKK-së, të cilët janë anëtarët e KKSB-së marrin pjesë rregullisht në mbledhje.

4.2 Zyra ka përcjellë punimet në objektet e shkatërruara nga zjarri në fshatin Novake në vitin e kaluar; gjatë periudhës raportuese është bërë pranim dorëzimi i dy objekteve.

5. Riintegrimi i personave të riatdhësuar dhe integrimi i të huajve

5.1. Gjatë periudhës raportuese, ZKKK-ja ka pranuar gjithsej 15 kërkesa, prej tyre 13 kërkesa për vazhdim akomodimi, ndërsa 2 kërkesë për herë të parë.

5.2 Takimet e KKR-së: Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 7 takime të KKR-së, ku janë shqyrtuar 13 kërkesa për vazhdim të akomodimit dhe dy kërkesë për herë të parë.

6. Bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare

6.1 Sipas marrëveshjes të Komunës, ZKKK-ja vazhdon bashkëpunimin me organizatat vendore dhe ndërkombëtare si: OSCE, UNHCR, UNMIK, IOM, AT, etj.

Rezultatet e bashkëpunimit: Në bashkëpunim me IOM-in është përgatitur Plan Biznes me IOM-in dhe një kabinet për një shkollë në Komunën e Prizrenit. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë

nënshkruar 3 kabinete për shkollat dhe një biznes plan. Përfitues nga Plani Biznes janë 4 persona- 2 nga komuniteti Rom, -1 Boshnjak dhe 1 Turk. Rastet e tjera janë procedur te sipërm.

6.2 Plani aksional për gjithëpërfshirjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjitian 2025-2028 –Plani Lokal i Veprimit është finalizuar. Në lidhje me këtë është kërkuar nga kryetari të dilet me vendim që të formohet grupi i Punës, i cili do të punojë për Përkthimin e planit të hartuar në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunës së Prizrenit.Plani aksional ka kaluar ne debat publik,ne Komitetin per Politik dhe Financa dhe me pastaj eshte aprovuar nga ana e kuvendarve te Asambles Komunale. Drejtorija per Ekonomi dhe Financa eshte zotuar publikisht se per vitin 2026 ky plan do te buxhetohet.

7. Shëndetësia

7.1 ZKKK-ja për periudhën Janar – Dhjetor 2025 i ka leshuar 600 vërtetime për shërim jashtë vendit.

8. Ngjarjet fetare dhe kulturore

8.1 ZKK-ja i ka përcjellë ngjarjet dhe aktivitetet fetare dhe kulturore të ortodoksëve.

8.2 Mirëmbajtja e varrezave ortodokse - Me interesimin dhe insistimin e të zhvendosurve nga fshati Ljubizhd në lidhje me pastrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave ortodokse të fshatit të tyre, ZKKK-ja ka reaguar tek autoritetet kompetente (kompanitë dhe institucionet) bashkëpunimi është në vazhdim.

9. Trajnimet, punëtoritë, konferencat, komisionet dhe aktivitete tjera

9.1 Vizitat në terren - ZKKK-ja rregullisht i viziton dhe kontakton me komunitetet në terren ku mes tjerash u theksuan problemet me KEDS-in lidhur me ndërrimin e shtyllave elektrike të rrënuara.

9.2 ZKKK-ja ka vizituar një familje e vetme nga komuniteti Ashkali, e cila është në gjendje të rëndë socio-ekonomike. Nga zyra e kemi ngritur çështjen e kësaj familjeje nëpër organizata humanitare për ndihmë në ushqim, veshmbathje dhe renovim, po ashtu e kemi referuar në Qendrën e komunitetit Loyola e cila gjendet në lagjen Arbana. Po ashtu është referuar edhe në QPS për ndihmë sociale te cilat me herët e ka marrë. Me ndihmën e ZKKK-se familja i ka permitsimet te dukshme ne aspektin Socio - ekonomik si dhe nre aspektin e arsimimit.

10 Takimet - ZKKK-ja ka marr pjesë në takime dhe punëtori të ndryshme lidhur me procesin e riatdhesimit me MPB-DRPRIH dhe me organizata siç janë GIZ, CRPK etj.

10.1 ZKKK-ja mori pjesë edhe në takimet e KKSb-së si dhe në takimin e Komitetit për Kthim.

10.2 Në periudhën raportuese, me 03 prill është formuar Kolegjiumi i Zyrës për Komunitet dhe Kthim në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Në të cilën ZKKK-ja e Prizrenit është anëtare e kryesisë së kolegjiumit

10.3 Me datë 7- 8 maj është mbajtur punëtorja e parë e Kolegjiumit të ZKKK-ve.

ZKKK-ja në muajin Tetor ka mar pjesë në takimin e Kolegjit të ZKKK-ve në kuadër të Asocacionit të Komunave të organizuar nga OSBE. Tema e takimit ka qenë përmirësimi i kushteve të ZKKK-ve si dhe bashkëpunimi ndër Institucjonal.

10.4 ZKKK-ja merr pjesë si anëtare e komisionit për shqyrtimin e kërkesave nga DUPH për Qendrën e Trashëgiminë Kulturore dhe në afatin e paraparë janë shqyrtuar dhe është përgjigjur në 65 kërkesat te parashtruara.

10.5 ZKKK-ja është në bashkëpunim edhe me Drejtorit komunale ku merr pjese edhe në komisione te ndryshme.

10.6 Si dhe aktivitete e përditshme të zyrës.

**Prizren,
Datë:**

**Udhëheqësja e ZKKK-së
Derya Kala**